



VENDIMI dhe GJETJET

Data e miratimit: 12 nëntor 2015

Nr. i lëndës 2014-18

Fitim Maksutaj

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 12 nëntor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 19 mars 2014. Ankuesi ka paraqitur informata shtesë më 21 tetor 2014.

2. Më 17 nëntor 2014, Paneli ka vendosur të njoftoj rreth ankesës shëfin e Misionit (ShM) të EULEX-it, duke e ftuar atë të paraqes vërejtje me shkrim për ankesën. Vërejtjet e ShM-së janë pranuar më 18 shkurt 2015, ku pastaj janë përkthyer dhe i janë komunikuar parashtruesit të ankesës për vërejtjet e tij shtesë.
3. Më 27 maj 2015, ankuesi ka parashtruar vërejtjet shtesë në përgjigje ndaj vërejtjeve të ShM.
4. Vërejtjet shtesë të parashtruara nga ankuesi janë komunikuar nga Paneli tek ShM-ja më 19 gusht 2015.

II. FAKTET

5. Më 11 tetor 2006, prokurori ndërkombëtar i UNMIK-ut lëshoj një vendim lidhur me nisjen e një hetimi kundër parashtruesit të ankesës dhe gjashtë bashkë të pandehurve të tjerë për veprat si: (i) shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit (neni 339 i Kodit Penal të Kosovës i vitit 2004 (KPK) dhe (ii) falsifikimi i dokumenteve (neni 332 i KPK-së), për parregullsitë që kanë të bëjnë me menaxhimin e llogarive të të hollave në burgun e Dubravës.
6. Më 29 nëntor 2006, ankuesi ishte arrestuar bazuar në urdhrin për arrestim të lëshuar nga një gjykatës i procedurës paraprake më 28 nëntor 2006. Më 29 nëntor 2006, prokurori i Zyrës së Prokurorisë së Qarkut të Pejës, sipas KSHZ-së nr. 132/06 ka bërë kërkesë për paraburgim të parashtruesit të ankesës dhe një bashkë të pandehur tjetër, S.L. Prokurori ka kualifikuar veprat penale si shpërdorim të detyrës (neni 340 (1) dhe (3) të KPK-së) dhe falsifikim të dokumenteve (neni 332 KPK). Më 29 nëntor 2006, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Pejës ka refuzuar kërkesën për paraburgim dhe në vend të saj ka lëshuar një urdhër për kufizim të lëvizjes ndaj ankuesit, duke e ndaluar atë që t'i afrohet një vendi dhe personi të saktësuar (neni 272 i Procedurës së Kodit Penal të Kosovës 2004 (KPPK). Ky urdhër ishte lëshuar edhe kundër bashkë të pandehurit S.L. Kjo masë ishte vazhduar nga gjyqtari i procedurës paraprake në disa raste (deri më 28 shkurt 2007, 28 mars 2007, 28 maj, 2007, 28 korrik 2007, 28 gusht 2007, 28 tetor 2007, 28 nëntor 2007, 28 janar 2008 dhe 28 shkurt 2008.
7. Më 18 shkurt 2008, Paneli i Gjykatës së Qarkut të Pejës, *proprio motu* ndërpreu urdhrin e masës mbrojtëse ndaj ankuesit.
8. Më 28 shkurt 2008, prokurori kundërshtoj vendimin e Gjykatës së Qarkut, i cili ishte lëshuar nga një Panel i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme më 28 korrik 2008. Masa e kufizimit të lëvizjes ishte rikthyer ndaj ankuesit dhe bashkë të pandehurit S.L. për një muaj deri më 29 gusht 2008.

Hetimi fillestar i lëndës nga UNMIK-u 2006-2008

9. Më 4 maj 2007, prokurori ndërkombëtar lëshoj një vendim për zgjerimin e hetimeve me qëllim të nisjes së një hetimi ndaj një të dyshuari tjetër, H.N., duke e çuar numrin e të dyshuarve në tetë.
10. Më 28 maj 2007, gjyqtari i procedurës paraprake zgjati periudhën e hetimit ndaj ankuesit dhe bashkë të pandehurit S.L. për veprat penale të parashikuara në nenet 339 dhe 332 të KPK-së deri më 11 tetor 2007. Kërkesa ishte pranuar në përgjigje të një kërkesë të prokurorit parashtruar me 6 prill 2007 dhe më pas ndryshuar me 4 maj 2007. Prokurori ndërkombëtar, në kërkesën e saj të ndryshuar, ka informuar Gjykatën se pesë bashkë të pandehur të tjerë në rast nuk konsideroheshin më të dyshuar, por dëshmitarë të rastit.
11. Më 24 korrik 2007, prokurori pezulloj hetimin ndaj të dyshuarit H.N.
12. Më 27 gusht 2007, gjyqtari i procedurës paraprake, duke vepruar në bazë të kërkesës së prokurorit, ka ndryshuar urdhrin e vazhimit të hetimeve ndaj ankuesit në lidhje me veprat penale të shpërdorimit të rëndë në detyrë (neni 340(1) dhe (3) KPK) dhe falsifikimin e dokumenteve (Neni 332 (1) dhe (3) KPK).
13. Më 26 shtator 2007, prokurori intervistoj ankuesin si të dyshuar për veprat penale të parashikuara në nenet 340 (1) dhe (3) dhe 332 (1) dhe (3) QKK. Gjithashtu S.L. ishte intervistuar nga prokurori si i dyshuar më 25 shtator, 1 dhe 3 tetor 2007.
14. Më 1 tetor 2007, prokurori ka ndryshuar vendimin e tij për nisjen e një hetimi ndaj ankuesit dhe S.L. në mënyrë që të përfshihen veprat penale të parashikuara në nenin 340 (1) dhe (2) të KPK.
15. Më 4 tetor 2007, prokurori rifilloj hetimet kundër H.N. për përfshirjen e veprës penale të shpërdorimit të rëndë në detyrë siç është parashikuar në nenin 340 (1) dhe (3) të KPK-së. Më 5 tetor 2007, prokurori ka bërë kërkesë për urdhër për arrestim, fletërreshtim ndërkombëtar dhe paraburgim për H.N.
16. Më 26 tetor 2007, gjyqtari i procedurës paraprake ka zgatur periudhën e hetimit deri më 11 prill 2008 në bazë të një kërkesë nga prokurori.
17. Më 12 nëntor 2007, gjykatësi ndërkombëtar i procedurës paraprake ka lëshuar një urdhër për arrestimin, Fletërreshtim dhe një Fletërreshtim ndërkombëtarë ndaj H.N.
18. Më 14 shkurt 2008, një aktakuza kundër ankuesit ishte ngritur nga prokurori në Gjykatën e Qarkut në Pejë (PPQ nr. 37/07). Më 6 prill 2008, kopjet e dosjeve të lëndës i janë dorëzuar Këshillit për ankuesin nga ana e zyrës së prokurorit ndërkombëtar në përputhje me nenin 307 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK).

Hetimi i lëndës nga ana e EULEX-it 2009 – Deri tash

19. Dosjet e lëndës që kanë të bëjnë me rastet e mësipërme ishin bartur nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut tek prokurorët e EULEX-it diku midis 1 janarit dhe 4 shkurt 2009. Në atë periudhë, rastet kundër ankuesit dhe S.L. ishin në pritje të konfirmimit të akuzave në lidhje me veprat e supozuara penale të parashikuara në nenet 340 (1) dhe (3) dhe, 332 (1) dhe (3) KPK-së. Përveç kësaj, ka qenë një urdhër valid për arrestim, Fletërreshtim dhe Kërkesë për Fletërreshtim ndërkombëtar ndaj H.N.
20. Më 4 shkurt 2009, prokurorët e EULEX-it kanë paraqitur një kërkesë te gjykatësi konfirmues i Gjykatës së Qarkut Pejë, duke i kërkuar kthimin e dosjeve të lëndës së ndjekjes penale, duke iu referuar neneve 304, 306, 326 dhe 376 të KPPK-së (neni 304-Parashtrimi i aktakuzës; neni 306-Shqyrtimi i parë i aktakuzës dhe përputhja e saj me nenin 305; neni 326-tërheqja e aktakuzës para seancës së shqyrtimit kryesor; neni 376-amendamenti dhe vazhdimi i aktakuzës.
21. Më 9 shkurt 2009, një gjykatës konfirmues i EULEX-it refuzoj kërkesën e prokurorëve të EULEX-it për kthimin e dosjeve të lëndës mbi bazën se kërkesa nuk ishte në përputhje me ligjin e Kosovës (Vendimi KAQ Nr. 45/08).
22. Më 11 shkurt 2009, prokurorët e EULEX-it kanë paraqitur edhe një parashtrësë tjetër në Gjykatën e Qarkut në Pejë, në përgjigje të vendimit të mëparshëm të gjykatësit konfirmues, duke deklaruar se ata kishin tërhequr aktakuzën dhe kërkonin kthimin e dosjeve të lëndëve në mënyrë që të rivlerësohen lëndët dhe të bëhen hetime plotësuese me qëllim që të përgatitet një aktakuzë e re.
23. Më 13 shkurt 2009, gjykatësi konfirmues ka lëshuar një urdhër që dosjet e lëndëve t'i kthehen prokurorëve të EULEX-it dhe duke konfirmuar tërheqjen e aktakuzës ekzistuese.
24. Më 21 maj 2009, prokurori ka kërkuar nga Drejtoria e Policisë Rajonale të Kosovës në Pejë të hyjnë në një dhomë në burgun e Dubravës dhe të bëjnë një inventar të dosjeve dhe materiale përkatëse lidhur me lëndën, t'i ruajnë ato materiale në Policinë e Kosovës ("KP") dhe t'i raportojnë prokurorit për veprimet e ndërmarra. Dhoma në fjalë ishte plumbuar nga *Guardia di Finanza* diku në vitin 2006.
25. Më 26 maj 2009, PK-ja ka raportuar se hetuesit së bashku me katër zyrtarë policor të EULEX-it dhe një përkthyes kanë shkuar në burgun e Dubravës. Ishte e nevojshme që dera e dhomës të hapet me forcë, pasi ajo ishte e mbyllur dhe nuk kishte çelësa. Me të hyrë në dhomë, u zbulua se një dritare ishte e hapur dhe kishte një numër të konsiderueshëm të pëllumbave të ngordhur dhe të gjallë. Zyrtarët mund të shihnin se kanë qenë rreth 60-70 dosje me dokumente që ishin plumbuar nga *Guardia di Finanza*, mirëpo ishte e pamundur që të merreshin këto dosje, për shkak të kushteve në dhomë dhe nëse

do të veprohej një gjë e tillë do të ishte rrezik serioz për shëndetin e zyrtarëve në fjalë. Pas fotografimit të ngjarjes, zyrtarët në bazë të këshillës së prokurorit të EULEX-it nuk prekën asgjë dhe dosjet mbeten në vendin e ngjarjes.

26. Më 26 mars 2010, policët e EULEX-it raportuan prokurorin e EULEX-it se kishin monitoruar hapjen e dhomës së plumbuar në burgun e Dubravës me 26 maj 2009. Ata gjithashtu theksuan se dhoma në fjalë më pas ishte pastruar nga një kompani profesionale pastrimi dhe se pastrimi i dhomës ishte mbikëqyrur nga zyrtarë të PK-së nga Stacioni Policor i Istogut. Zyrtarët policor të EULEX-it deklaruan se kolegët e tyre të Njesisë Anti-Korrupsion të PK-së nuk ishin njoftuar paraprakisht për pastrimin e dhomës dhe vetëm më vonë u njoftuan për te. Zyrtarët e policisë së EULEX-it kanë deklaruar se kjo ishte shkelje e qartë e marrëveshjes së arritur në meste Burgut të Dubravës, prokurorit të EULEX-it dhe zyrtarëve policor të EULEX-it.
27. Më 4 maj 2010, ankuesi i ka shkruar prokurorit të EULEX-it një kërkesë rreth statusit të lëndës së tij, e cila ishte regjistruar si ankesë nga ana e EULEX-it (Nr. i regjistrimit të ankesës 132/2010).
28. Më 6 korrik 2010, prokurori i EULEX-it iu përgjigj ankuesit duke deklaruar se lënda ishte në shqyrtuar dhe i ishte nënshtruar procedurave ligjore. Prokurori i EULEX-it e këshilloj ankuesin që të kërkojë këshillë të pavarur ligjore *“marrë parasysh natyrën e lëndës pa vonesa të mëtejshme”*. Përveç kësaj, prokurori i EULEX-it e informoj ankuesin se mbrojtësi i tij i emëruar *“do të kontaktohet në kohën e duhur, kur lindin zhvillime të mëtejshme në këtë lëndë”*.
29. Më 29 qershor 2011, ankuesi përsëri ka kontaktuar prokurorin e EULEX-it, duke u ankuar se prej ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit ndërkombëtar në shkurt të vitit 2008, ai nuk kishte qenë i informuar për statusin e lëndës. Në komunikimin e tij, ankuesi përmendi se i ishte dhënë informata se aktakuza ishte tërhequr. Ai kërkoj ndihmën e prokurorit të EULEX-it në zgjidhjen e kësaj çështje, pasi ai nuk ishte në gjendje të punësohej pa dëshmi të dokumentuar që do të tregonte se ai nuk ishte nën hetime. Lënda ishte regjistruar si ankesë nga EULEX-i (nr. i regjistrimit të ankesës 137/2011).
30. Më 15 mars 2013, prokurori i EULEX-it ka ndërprerë hetimet ndaj H.N. në mungesë të dyshimit të arsyeshëm. Në këtë vendim, prokurori i EULEX-it ka njoftuar gjykatësin e procedurës paraprake të EULEX-it... *“rreth faktit se aktakuza [ndaj ankuesit dhe S.L.] është tërhequr dhe riparashtrimi i së njëjtës aktakuzë do të mbyllet në pajtim me nenin 292(2) dhe lënda ndaj tyre po ashtu konsiderohet e mbyllur”*.
31. Më 15 dhjetor 2014, Gjykata Themelore e Pejës ka lëshuar një vendim, ku i hedh poshtë akuzat ndaj ankuesit dhe S.L. (KAQ nr. 45/08 e datës 15/12/2014. Vendim në aktakuzë PPQ NR-37/07, e parashtruar në Gjykatë me 14/02/2008).

III. ANKESAT

32. Ankuesi kërkon nga një "Gjykatë e EULEX-it" të informohet rreth statusit të lëndës së tij e posaçërisht konfirmim se hetimi ndaj tij është ndërprerë. Ankuesi pohon se "i nevojitet një vendim nga Gjykata e EULEX-it se hetimet rreth lëndës së tij janë ndërprerë" në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkoj që të rikthehet në pozitën e tij të mëhershme të punës.
33. Ankuesi pretendon se ka shkelje të të drejtave të tij, siç parashihet me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

Veprimi i Përbashkët

34. Neni 2 dhe 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË (më tutje si: Veprimi i Përbashkët), vijon si më poshtë:

Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i në Kosovë do të ndihmoj institucionet e Kosovës, organet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira evropiane.

EULEX-i në KOSOVË, në bashkëpunim të plotë me Programin për Ndihmë të Komisionit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke ruajtur përgjegjësi të caktuara ekzekutive.

Neni 3 Detyrat

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

- (a) monitoroj, udhëzoj dhe këshilloj institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor), përderisa i ruan disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive;
- ...
- (d) të siguroj që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ndëretnik, krimit financiar/ekonomik dhe krimeve tjera të rënda të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen siç duhet, sipas ligjit në fuqi, përfshirë, kur është e përshtatshme, nga hetues, prokurorë dhe gjykatës ndërkombëtarë së bashku me hetuesit, prokurorët dhe gjykatësit e Kosovës ose në mënyrë të pavarur dhe përmes masave duke përfshirë, nëse ka nevojë, krijimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të strukturave ndërmjet autoriteteve policore dhe të prokurorisë;
- (e) kontribuoj për fuqizimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit nëpër mbarë procesin juridik, sidomos në fushën e krimit të organizuar;
- (f) kontribuoj në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar;

V. LIGJI

35. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të Punës. Paneli konstaton se nuk janë parashtruar vërejtje nga palët në lidhje me pranueshmërinë e ankesës.
36. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të Rregullores së Punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, polici dhe sektorët e doganave.
37. Sipas Rregullës në fjalë, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Për shkak të pritjeve të vogla, nuk është funksion i Panelit që të merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave që i atribuohen gjyqësorit të Kosovës.
38. Paneli ka gjetur më parë se veprimet e ndërmarra nga një prokurori i EULEX-it gjatë shqyrtimit të një lënde janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit për aq kohë sa nuk është ngritur ndonjë aktakuzë në ndonjë gjykatë kompetente për t'i shqyrtuar meritat e një lënde (*Shih B.Y kundër EULEX-it*, 2014-06, par. 12, *I kundër EULEX-it*, 2013-01, 27 nëntor 2013, par. 12; *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, në par. 20-22; *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013 në par. 32; *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012 në par. 21; *Hoxha kundër EULEX-it*, 2011-18, 23 nëntor 2011 at par. 22; *S.M. kundër EULEX-it*, 2011-11, 23 nëntor 2011 në par.15, *Sadik Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, par. 64).
39. Duke marrë parasysh faktet e kësaj lënde, Paneli është i bindur se sjellja për të cilën ka ankesa lidhet drejtpërdrejtë me veprimet e prokurorëve të EULEX-it në kryerjen e funksioneve të tyre ekzekutive në mes të janarit 2009 dhe dhjetorit 2014, gjatë së cilës kohë prokurorët e EULEX-it kanë qenë përgjegjës për hetimin penal kundër ankuesit.
40. Në rrethana të tilla, Paneli njëzëri vendos se ankesa hyn në kuadër të mandatit të tij dhe i plotëson kriteret e pranueshmërisë ashtu siç janë të përcaktuara.

VI. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

Ankesa

41. Siç u përmend më lartë, ankuesi pretendon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 6 të KEDNJ-së.

42. Paragrafët përkatës të kësaj dispozite thonë si vijon:

Neni 6 E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendos mbi të drejtat dhe detyrimet e tij apo të çdo akuze penale ndaj tij...

Parashtrirat nga palët

Kohëzgjatja e procedurës

43. Ankuesi pohon se hetimi penal ndaj tij ka filluar më 11 tetor 2006 dhe nuk është ndërprerë deri më 15 dhjetor 2014, kështu që përfshin një periudhë prej më shumë se tetë vjet e dy muaj.
44. Ankuesi më tej pohon se si rezultat i hetimeve të vazhdueshme ndaj tij, ai nuk ishte në gjendje që të punësohej gjatë asaj periudhe kohore.
45. Në parashtrimet e tij, ShM-ja e pranon se lënda i ishte bartur EULEX-it nga UNMIK-u në janar të vitit 2009 dhe se ajo kishte përfunduar me anë të një vendimi përfundimtar nga Gjykata Themelore e Pejës në dhjetor 2014.
46. Për më tepër, ShM-ja pohon se prokuroria e EULEX-it ka ndërmarrë masa hetimore lidhur me lëndën në vitin 2009 dhe fillim të vitit 2010 dhe thotë se ka qenë një periudhë prej marsit 2010 deri në mars të vitit 2013 kur nuk ka pasur përpjekje nga prokurori që ta përfundojë lëndën. Është pohuar edhe nga ShM-ja se më 15 mars 2013 prokurori i EULEX-it ka ndërprerë zyrtarisht hetimet kundër bashkë të pandehurit të ankuesit dhe ka konsideruar lëndën kundër ankuesit si të mbyllur, në përputhje me nenin 292(2) të KPP-së. Zyra e kryeprokurorit të EULEX-it ka bërë shqyrtimin e lëndës së ankuesit në nëntor 2014.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të ankuesit sipas nenit 6 (1) të Konventës, ShM-ja pohon se *“ekziston e drejta për një proces brenda një kohe të arsyeshme në mënyrë që i akuzuari nuk duhet të përballë me një akuzë për një kohë të gjatë dhe caktohet akuza”*. Më tej pohohet se vlerësimi i asaj çfarë konsiderohet afat i arsyeshme varet nga një numër faktorësh duke përfshirë kompleksitetin e lëndës, sjelljen e të akuzuarit si dhe sjelljen e autoriteteve.

47. Në këtë drejtim, ShM-ja pohon se asgjë në çështjen në fjalë nuk sugjeron se sjellja e ankuesit e ka zgjatur lëndën dhe se hetimet e brendshme të EULEX-it nuk kanë zbuluar se rasti pas aktakuzës ishte veçanërisht i komplikuar. ShM-ja më tej ka pohuar se edhe në qoftë

se kishte me qenë kështu, kjo nuk mund t'i liroj autoritetet nga së paku përpjekja që ta çojnë lëndën përpara.

48. Për më tepër, ShM-ja pranon se hetimi nuk kishte përfunduar brenda afatit që në mënyrë ideale EULEX-i do të donte.

Informimi i ankuesit

49. Ankuesi pohon se ai nuk ishte informuar nga EULEX-i për statusin e hetimit dhe ndjekjen penale ndaj tij.
50. Ankuesi pohon se më 29 qershor të vitit 2011, ai ka kërkuar nga prokurori i EULEX-it "*asistencë për të zgjidhur lëndën time*" për shkak se ai nuk ishte në gjendje të punësohej pa ndonjë dokument që tregon se ai nuk ishte më nën hetime. Ankuesi pohon se asnjëherë nuk ka marrë ndonjë përgjigje ndaj kësaj letre nga ana e EULEX-it.
51. Në përgjigje, ShM-ja pohon se para se EULEX-i të merrte përsipër lëndën, nuk kishte asnjë obligim nga ana e EULEX-it që të informonte ankuesin rreth statusit të lëndës ndaj tij. ShM-ja më tej pohon se prokurorët e EULEX-it nuk e kanë informuar ankuesin për tërheqjen e aktakuzës që ka ndodhur më 11 shkurt 2009, pasi ata kishin qëllim të vazhdonin procedurën penale kundër tij dhe gjithashtu në bazë të KPPK-së prokurori nuk kishte asnjë obligim që ta informoj ankuesin. Më tej ai pohon se neni 326 i KPPK-së obligon Gjykatën që të njoftoj palët në procedurë nëse aktakuza është tërhequr pasi lënda të ketë arritur fazën e shqyrtimit kryesor dhe ka shënuar se KPPK-ja nuk ka parashikuar një situatë ku padia tërhiqet në një fazë më të hershme.
52. ShM-ja gjithashtu pohon se ankuesi në fakt e dinte se aktakuza ishte tërhequr për shkak se ai e ka përmendë atë në letrën e tij të mëvonshëm dërguar prokurorit. ShM-ja sugjeron se prokurori i EULEX-it e informoj ankuesin më 6 korrik 2010 se lënda e tij ishte në shqyrtim e sipër dhe se ende ishte duke iu shqyrtuar procedurave gjyqësore. Ai gjithashtu pranon se EULEX-i nuk iu përgjigj kërkesës së ankuesit për informata të datës 29 qershor 2011, por sugjeroj se prokurorët e EULEX-it nuk ishin të obliguar me ligj që të bënin këtë dhe kjo nuk i ka prekur të drejtat e ankuesit sipas neneve 6 të Konventës.
53. Në përgjigje të vërejtjeve të ShM-së, ankuesi pohon se këto vërejtje në të vërtetë kanë për qëllim ta minimizojnë, nëse jo plotësisht ta eliminojnë përgjegjësinë e prokurorëve të EULEX-it në lidhje me lëndën e tij. Ai më tej pohon se nuk ishte informuar nga EULEX-i për faktin se aktakuza e ngritur kundër tij ishin tërhequr ose se prokurorët e EULEX-it kishin qëllim të vazhdonin procedurën penale kundër tij, pavarësisht kërkesave të tij të vazhdueshme për informata.

Vlerësimi i Panelit

54. Paneli tashmë ka pasur rast të theksoj se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohen në të gjitha aspektet përkatëse të asaj që mund të pritet prej një shteti (A,B,C,D kundër EULEX-it nr. 2012-09 deri te 2012-12, 20 qershor 2013, § 50; K deri te T kundër EULEX-it, e cituar më lartë, § 53; krahasoni gjithashtu vendimin e PShDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35).
55. Prandaj në çdo rast, Paneli pritet të shqyrtoj nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund ta kenë dëmtuar mundësinë që EULEX-i të kryej një hetim të shpejtë dhe efektiv rreth një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikoj të metat operationale që nuk lidhen me sfida konkrete dhe të dukshme.
56. Në çdo rast, autoritetet hetimore priten të veprojnë shpejt për aq sa është e arsyeshme dhe të përdorin burime në përputhje me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa autoritetet hetuese nuk mund të priten t'i zgjidhin të gjitha lëndët e sjella para tyre, prej tyre pritet që në çdo rast të veprojnë me kujdes, shpejtësi dhe efikasitet të tillë që e pasqyrojnë seriozitetin e lëndës që është duke u hetuar. Një angazhim dhe përkushtim i rreptë me këto standarde është veçanërisht i rëndësishme për një mision të sundimit të ligjit si EULEX-i që ka për qëllim të shërbej si shembull i përkushtimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për ndërtimin e një ndjenje të fortë të përgjegjësisë ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Çfarëdo standardi më pak se ky do të rrezikonte krijimin e një ndjenje pajtimi me mosndëshkimin dhe mospërfilljen e kërkesës legjitime të viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (vendimi i PShDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09).
57. E drejta për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm siç kuptohet në bazë të nenit 6 (1) të Konventës është projektuar për të mbrojtur *“të gjitha palët në procedurat gjyqësore... ndaj vonesave të tepërta procedurale (shih Stogmuller kundër Austrisë A 9 (1969) fq.40; 1 EHHR 155, 191) ...Përveç kësaj, në rastet penale e drejta është projektuar për të shmangur që një person i akuzuar duhet të qëndroj një kohë të gjatë në një gjendje pasigurie rreth fatit të tij”* (Stogmuller kundër Austrisë A 9 (1969) fq.40; 1 EHHR 155, 191. Cf, *Wemhoff kundër FRG A 7 (1968); 1 EHRR 55*).
58. Në shqyrtimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës, Paneli është i detyruar të shqyrtoj rrethanat e veçanta të lëndës dhe të merr parasysh këta faktorë relevante me këtë vlerësim: (1) kompleksitetin e çështjes, (2) sjelljen e aplikantit dhe: (3) sjelljen e administratës kompetente (shih *Konig kundër FRG A 27 (1978); 2 EHRR 170 PC* dhe *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës 2004-XI; 42 EHHR 486 GC*).

59. Paneli vënë re parashtrirat e të dyja palëve në lidhje me këto kritere. Në veçanti, Paneli e vënë re pranimin e ShM-së se asgjë në këtë lëndë nuk sugjeron që sjellja e ankuesit e ka zgjatur hetimin e kësaj lënde dhe se nuk ka asgjë për të sugjeruar se lënda kundër tij ishte në veçanti e komplikuar. Paneli për më tepër vënë re parashtrirat e ShM-së, në të cilën ai pranon se ka pasur një periudhë midis marsit të vitit 2010 dhe marsit të vitit 2013, kur nuk ka pasur përpjekje nga ana e prokurorit për të çuar përpara dhe përfunduar lëndën dhe se lënda nuk është përfunduar brenda një afati kohor që EULEX-i mund të kenë dëshiruar.
60. Në shqyrtimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes që është marrë për të zgjidhur këtë rast, Paneli nuk ka marrë parasysh periudhën fillestare, në të cilën UNMIK-u e kishte lëndën. Paneli e ka kufizuar shqyrtimin e saj në periudhën e kohës kur EULEX-i ka qenë përgjegjës për hetimin e kësaj lënde (nga janari 2009 deri në dhjetor të vitit 2014). Megjithatë Paneli vëren se kohëzgjatja e përgjithshme e procesit ndaj ankuesit është e rëndësishme për të vlerësuar urgjencën me të cilën Misioni ka vepruar në zgjidhjen e kësaj lënde.
61. Siç është parashtruar më lartë, Paneli pranon se kur lënda ishte parashtruar në Prokurorinë e EULEX-it nga UNMIK-u në janar të vitit 2009, ka pasur një përpjekje fillestare nga prokurori i EULEX-it që ta tërheq aktakuzën e “trashëguar” ndaj ankuesit, me synimin që të zgjeron hetimin ndaj tij. Përfundimisht pasi u arrit sukses që aktakuza të tërhiqej me 13 shkurt 2009, prokurori i EULEX-it ka dërguar një kërkesë në PK me 21 maj 2009 për të bastisur një dhomë në burgun e Dubravës për dosje dhe dokumente që kanë të bëjnë me hetimin. Dosjet nuk ishin marrë për arsyet e parashtruara më sipër. Këto fakte ishin raportuar te prokurori i EULEX-it nga ana e PK-së me 26 maj 2009.
62. Duket se hapi tjetër i ndërmarrë në lidhje me këto dosje dhe dokumente ishte në mars të vitit 2010, kur policët e EULEX-it iu përgjigjën një kërkesë nga prokurori i EULEX-it për ta ofruar një informata të re rreth statusit të dokumenteve dhe dosjeve. Policia e EULEX-it ka raportuar se vendndodhja e dosjeve dhe dokumenteve ishte e panjohur pasi ato ishin larguar nga dhoma e burgut të Dubravës gjatë kësaj periudhe. Nuk janë paraqitur prova për të kundërtën e kësaj, e duket se prokurori i EULEX-it nuk ka marrë ndonjë veprim të mëtejshëm që t'i merr këto dosje dhe dokumente.
63. Paneli konsideron se trajtimi i këtij elementi të veçantë të hetimit nga prokurori i EULEX-it pa ndonjë shpjegim bindës dhe pa ndonjë dëshmi të përcjelljes së këtij hetimit, përbën një mangësi serioze të hetimit. Kjo ka ndikuar në kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit pa ndonjë dobi të dukshëm të zgjidhjes së tij. Paneli është i ndërgjegjshëm për praktikën gjyqësore të Gjykatës në këtë drejtim, ku ka gjetur shkelje të nenit 6 (1) të Konventës mbi bazën e një shembulli të vetëm vonese të pashpjegueshme të kohëzgjatjes së mjaftueshme, pavarësisht kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave (shih

Bunate Bunkate kundër Holandës A 248-B (1993); 19 EHHR 477. Cf, Kudla kundër Polonisë 2000-XI; 25 EHHR 198 GC). Paneli është i mendimit se këto mangësi të hetimit kishte një ndikim negativ në kohëzgjatjen e përgjithshme që iu desh për të vendosur rreth këtij rasti dhe ka kontribuar në mohimin e së drejtës së ankuesit për një zgjidhje të shpejtë të lëndës ndaj tij.

64. Paneli gjithashtu ka shqyrtuar pasojat e këtyre mangësive për të akuzuarin (*Frydlender kundër Francës 2000-VII; 31 EHHR 1152 GC*). Paneli vëren se ankuesi i ka saktësuar shumë qartë prokurorit të EULEX-it, në letrën e tij të datës 29 qershor 2011, se ai aktualisht nuk ishte në gjendje për t'u punësuar përderisa ishte nën hetime dhe ka nxitur prokurorin e EULEX-it që ta zgjidh këtë çështje. Paneli tërhoqi vëmendjen drejt qasjes së Gjykatës në lidhje me lëndët kur administrata kërkohet që të bëjë me shpejtësi zgjidhjen e lëndës në bazë të ndikimit të dëmshëm (përfshirë edhe mundësitë për punësim) ndaj ankuesit (shih, p.sh. *Buchholz kundër FRG A 42 (1981); 3 EHHR 597. Cf, Eastaway kundër MB-së hudoc (2004) (drejtor kompanie)*)).
65. Paneli vëren se pavarësisht që prokurori i EULEX-it ishte njoftuar rreth vështirësisë së ankuesit *lidhur me* punësimin e tij, asnjë përgjigje nuk i ishte ofruar ankuesit ndaj kërkesës së tij për sqarim dhe zgjidhje të çështjes. Deri me 15 mars 2013 prokurori i EULEX-it nuk ka lëshuar asnjë aktvendim për pushimin e hetimit ndaj H.N., bashkë të pandehurit të ankuesit.
66. Paneli është i ndërgjegjshëm rreth statusit ligjor të procedurës që ka ekzistuar në atë kohë në lidhje me ankuesin dhe ka vënë re se prokurori i EULEX-it ishte përpjekë të përdor Aktvendimin për Përfundim, të lëshuar në lidhje me H.N. për të njoftuar rreth pozicionit të tij në lidhje me lëndën kundër parashtruesit të ankesës dhe një bashkë të pandehuri, S.L., duke e njoftuar gjykatën "rreth faktit se aktakuza në këtë rast është tërhequr dhe riparashtrimi i të njëjtit aktvendim do të mbyllet në përputhje me nenin 292(2) dhe gjithashtu lënda kundër tyre do të konsiderohet e mbyllur". Megjithatë, kjo nuk ka ofruar asnjë lloj mjeti juridik për mbrojtjen e të drejtës së ankuesit sipas nenit 6(1) të Konventës.
67. Paneli gjithashtu thekson se kjo lëndë u shqyrtua nga zyra e kryeprokurorit të EULEX-it vetëm pasi kjo ankesë ju komunikua ShM-së. Ky shqyrtim më në fund kishte çuar drejt një vendimi që të kërkohej nga Gjykata e Qarkut e Pejës për të lëshuar një vendim që hedh poshtë aktakuzën ndaj ankuesit dhe ndërprerjen e procedurës penale ndaj tij.
68. Bazuar në atë që u tha më lartë dhe duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të këtij rasti, Paneli është i mendimit se procedurat (të cilat kanë zgjatur nga janari 2009 deri më 15 dhjetor 2014) nuk ishin kryer me një shkallë të duhur kujdesi dhe shpejtësisë. Lënda ishte lënë e paprekur për një periudhë të gjatë kohore dhe ankuesi kishte mbetur në paqartësi lidhur me statusin e lëndës së tij përkundër kërkesave të

përsëritura për sqarim. Këto vonesa të paarsyeshme kanë rezultuar në shkeljen e të drejtës së ankuesit për një proces të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 6 (1) të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

1. **I shpall** ankesat në lidhje me procedurën penale të ndërmarra kundër ankuesit nga ana e EULEX-i në mes të janarit 2009 dhe 15 dhjetorit 2014, të pranueshme;
2. **Gjen se ka pasur** një shkelje të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;
3. **Shpall** se në dritën e gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit është e përshtatshme që të bëhen rekomandime për ShM, dhe

REKOMANDON KËTO VEPRIME:

- ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku e pranon se rrethanat e rastit përbëjnë shkelje të të drejtave të ankuesit që i atribuohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv.
- ShM-ja duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të shqyrtoj se çfarë hapash mund të ndërmerren nga zyra e kryeprokurorit të EULEX-it (ZKPE) për të siguruar që lëndët nën autoritetin e kësaj zyre trajtohen në përputhje me dispozitat e nenit 6(1) të Konventës dhe që ekziston një mekanizëm efektiv shqyrtues për të siguruar që të gjitha rastet e tilla trajtohen brenda një afati të arsyeshëm. Në lidhje me këtë, Paneli tërheq vëmendjen rreth faktit se kur kjo lëndë ishte shqyrtuar nga ana e ZKPE-së, lënda kishte përfunduar shpejtë.

Shefi i Misionit ftohet që të njoftoj Panelin dhe ankuesin rreth masave që janë ndërmarrë dhe rezultatet që ato i kanë dhënë, më së largu deri me datën 12 shkurt 2016.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese